

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika® CarboShear L

PETËZA PREJ FIBRASH KARBONI PËR PËRFORCIMIN E STRUKTURAVE SI PJESË E SISTEMIT PËRFORCUES SIKA® CARBODUR® CFRP

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika® CarboShear L janë petëza me fibra karboni rezistente ndaj korrodimit, të dizenuara për përforcimin e strukturave prej betoni në shkarje dhe për të ankoruar pllakat Sika® CarboDur® në fundet e tyre. Ato janë pjesë e Sistemit Përforcues Sika® CarboDur® CFRP.

Petëzat Sika® CarboShear L ngjiten si një përforcim i jashtëm duke përdorur ngjitësin me bazë rrëshire epokside Sikadur®-30 për temperatura normale, ose ngjitësin Sikadur®-30 LP me bazë rrëshire epokside për temperatura të larta gjatë aplikimit. Për fiksion brenda vrimave të ankorimit, mund të përdoret Sika AnchorFix®-3+.

Ju lutemi referohuni tek skeda teknike përkatëse për më shumë informacion të detajuar rreth secilit prej këtyre ngjitësve.

PËRDORIMET

Sika® CarboShear L duhet të përdoret vetëm nga profesionistë me përvojë.

Profilët Sika® CarboShear L përdoren për të përmirësuar, rritur ose riparuar performancën dhe rezistencën ndaj shkarjes të strukturës për:

Kapacitet i shtuar për bartje ngarkese:

- Rrit kapacitetin e trarëve për ngarkesë
- Për instalimin e makinerive të rënda
- Për ndryshimin e përdorimit të ndërtesës

Dëmtimet e elementeve të strukturës për shkak të:

- Përkeqësimit të materialeve origjinale të ndërtimit
- Korrodimit të armaturës prej çeliku
- Aksidenteve (goditje automjetesh, tërmete, zjarr etj.)

Përmirësim i shërbimit dhe qëndrueshmërisë:

- Reduktim i shtrëmbërimeve dhe gjërësisë së plasaritjeve
- Reduktim i forcimit në armaturën prej çeliku
- Rezistencë e përmirësuar ndaj lodhjes

Ndryshim i sistemit të strukturës:

- Heqja e mureve dhe / ose kolonave
- Heqja e dysHEMEVE dhe pjesëve të murit për të

krijuar hyrje / hapje

- Filozofi projektimi e ndryshuar
- Për riparimin e dizajnit ose defekteve të ndërtimit si:*
- Armime të pamjaftueshme / të papërshtatshme
- Thellësi strukturorë të pamjaftueshme / të papërshtatshme

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Sistem i testuar ankorimi
- Jo korrodes
- Rezistencë dhe qëndrueshmëri shumë të larta
- Përforcues kundër grisjes dhe shpërthimit
- Ankorim preciz
- Peshë e lehtë
- Trashësi e përgjithshme e ulët, mund të mbivishet
- Transportim i lehtë
- Instalim i lehtë – pa pajisje instalimi
- Rezistence e shkëlqyer ndaj lodhjes
- Kërkohej përgatitje minimale e petëzave
- Ndikim estetik minimal

MIRATIME / STANDARDE

- Poloni: Miratim teknik ITB AT-15-5604/2011: Zestaw wyrobów Sika CarboDur do wzmocnienia i napraw konstrukcji betonowych (Polonisht)
- Poloni: Miratim teknik IBDiM Nr AT/2008-03-0336/1 „Płaskowniki. pręty, kształtki i maty kompozytowe do wzmocnienia betonu o nazwie handlowej: Zestaw materiałów Sika CarboDur® do wzmocnienia konstrukcji obiektów mostowych (Polonisht)
- Raport testimi EMPA 169'219 E/1: Testing of CFRP shear strips on reinforced concrete T-beams T1 and T2, Swiss Federal Laboratories for Materials Testing and Research EMPA, 1998
- Raport testimi EMPA 169'219 E/2: Testing of CFRP shear strips. Flexural beam T3, Swiss Federal Laboratories for Materials Testing and Research EMPA, 1998
- Raport testimi EMPA 116/7: Shear strengthening with prefabricated CFRP L-shaped plates, Test beams

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Ambalazhi	Pako prej 20 petëzash, ose pjesë individuale																									
Paraqitja / Ngjyra	Polimer i përforcuar me fibra karboni me një matricë të zezë epokside																									
Jetëgjatësia	E pakufizuar, me kusht që të plotësohen kushtet e magazinimit.																									
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar në kushte të thata dhe temperaturë max. +50°C. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor. Transportimi: vetëm në ambalazhin origjinal, ose përndryshe mjaftueshëm i mbrojtur nga çdo dëmtim mekanik.																									
Dendësia	1.55 g/cm ³																									
Përmasat	Sika® CarboShear L është pllakë CFRP në formë L-je me përkulje 90° <table><thead><tr><th>Lloji</th><th>Këmbë e shkurtër</th><th>Këmbë e gjatë</th><th>Gjerësia</th><th>Trashësia nominale</th></tr></thead><tbody><tr><td>4/20/50</td><td>200 mm</td><td>500 mm</td><td>40 mm</td><td>2 mm</td></tr><tr><td>4/30/70</td><td>300 mm</td><td>700 mm</td><td>40 mm</td><td>2 mm</td></tr><tr><td>4/50/100</td><td>500 mm</td><td>1,000 mm</td><td>40 mm</td><td>2 mm</td></tr><tr><td>4/80/150</td><td>800 mm</td><td>1,500 mm</td><td>40 mm</td><td>2 mm</td></tr></tbody></table> Gjatësia e këmbës mund të pritet sipas përmasave të kërkuara (me sharrë, ose preferohet me disk prerës diamanti). Rrezja e brendshme e zonës së përkulur është 25 mm për të gjitha madhësitë	Lloji	Këmbë e shkurtër	Këmbë e gjatë	Gjerësia	Trashësia nominale	4/20/50	200 mm	500 mm	40 mm	2 mm	4/30/70	300 mm	700 mm	40 mm	2 mm	4/50/100	500 mm	1,000 mm	40 mm	2 mm	4/80/150	800 mm	1,500 mm	40 mm	2 mm
Lloji	Këmbë e shkurtër	Këmbë e gjatë	Gjerësia	Trashësia nominale																						
4/20/50	200 mm	500 mm	40 mm	2 mm																						
4/30/70	300 mm	700 mm	40 mm	2 mm																						
4/50/100	500 mm	1,000 mm	40 mm	2 mm																						
4/80/150	800 mm	1,500 mm	40 mm	2 mm																						
Përmbajtja e vëllimit të fibrave	> 56 %																									

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca e fletës ndaj tërheqjes	Vlerë mesatare > 1 350 N/mm ² <small>*Vlera në drejtim gjatësor të fibrave, duke konsideruar një trashësi nominale prej 2 mm</small>
Moduli i elasticitetit i fletëve në tërheqje	Vlerë mesatare 95 000 N/mm ² <small>Vlera në drejtim gjatësor të fibrave, duke konsideruar një trashësi nominale prej 2 mm</small>
Zgjatimi deri në thyerje i fletëve	Vlerë mesatare > 1.30 % <small>Vlera në drejtim gjatësor të fibrave, duke konsideruar një trashësi nominale prej 2 mm</small>

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Konsumimi	Ju lutemi referohuni tek "Method Statement Sika® CarboShear Përforcim kundër shkarjes i ngjitur jashtë" Ref: 850 41 06.
------------------	---

UDHËZIME APLIKIMI

betonit etj.)

CILËSIA E NËNSHTRESËS

Rezistenca minimale e rekomanduar e betonit ndaj tërheqjes pas përgatitjes së sipërfaqes

- Mesatare: 2.0 N/mm²
- Minimale: 1.5 N/mm²

Rezistenca efektive e betonit ndaj tërheqjes pas përgatitjes së sipërfaqes duhet të kontrollohet dhe konfirmohet.

Kur rezistenca ndaj tërheqjes është më e ulët se kërkesat minimale të dhëna më poshtë, disponohen zgjidhje alternative Sika®: Ju lutemi referohuni tek skedat teknike të pëlhurave SikaWrap®

Në përgjithësi, betoni duhet të jetë më i vjetër se 28 ditë (në varësi të kushteve të trajtimit dhe llojit të

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Ju lutemi referohuni tek "Method Statement Sika® CarboShear Externally Bonded Shear Reinforcement" Ref: 850 41 06.

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Ju lutemi referohuni tek skeda teknike përkatëse të:

- Sikadur®-30
- Sikadur®-30 LP
- Sika AnchorFix®-3+

Ju lutemi referohuni gjithashtu tek "Method Statement për përforcimin kundër shkarjes Sika® CarboShear me ngjitje të jashtme" Ref: 850 41 06.

KUFIZIME

Ju lutemi referohuni tek skedat teknike përkatëse të ngjitësve epoksid Sika®:

- Sikadur®-30
- Sikadur®-30 LP
- Sika Anchorfix®-3+

Një inxhinier strukturash posaçërisht i kualifikuar duhet të jetë përgjegjës për dizenjimin e punimeve të përforcimit.

Për shkak se ky aplikim është strukturor, duhet patur gjithashtu shumë kujdes edhe në përzgjedhjen e duhur të kontraktorëve specialistë me përvojë dhe të trajnuar.

Sistemet përforcuese Sika CarboShear® me profilet Sika® CarboShear L duhet të mbrohen nga ekspozimi i përhershëm ndaj rrezatimit diellor, lagështia dhe/ose uji. Ju lutemi referohuni tek Method Statement dhe skedat teknike për përzgjedhjen e materialeve të përshtatshme të mbiveshjes në situata ku sistemet do të ekspozohen plotësisht ose pjesërisht.

Temperatura maksimale e lejuar e shërbimit të vazhdueshëm është rreth +50°C.

Ju lutemi referohuni gjithashtu dhe tek "Method Statement të përforcimit Sika® CarboShear® me ngjitje të jashtme" Ref: 850 41 06 për kufizime dhe udhëzime të mëtejshme.

Kontakttoni me shërbimin teknik Sika për këshilla të detajuara.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

RREGULLORJA (EC) NO 1907/2006 - REACH

Ky produkt është një objekt siç përcaktohet në nenin 3 të rregullores (KE) Nr. 1907/2006 (REACH). Nuk përmban substanca që mund të çlirohen nga objekti nën kushte përdorimi normale ose të parashikuara arsyeshëm. Nuk nevojitet fleta e të dhënave të sigurisë në zbatim të nenit 31 të së njëjtës rregulloreje për të sjellë produktin në treg, transportuar apo përdorur atë. Për përdorim të sigurt, ndiqni udhëzimet që jepen në këtë fletë me të dhënat e produktit. Duke u bazuar në njohuritë tona aktuale, ky produkt nuk përmban SVHC (substances of very high concern / substanca me rrezikshmëri të lartë) siç renditen në Aneksin XIV të rregullores REACH apo në listën e substancave kandidatë të publikuar nga Agjencia Europiane e Kimikateve në përqëndrime më të mëdha se 0.2% (për peshë).

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sika® CarboShear L

Qershor 2019, Botimi 02.01

020206010040000002

SikaCarboShearL-sq-AL-(06-2019)-2-1.pdf

